

FTESË PËR ANKAND PUBLIK (Dhënia e hapësirave/lokaleve me qira)

1. Dhënia e hapësirave afariste me qira

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë njofton të gjithë të interesuarit se ofron hapësirat/lokalet për qiradhënie përmes procedurës së ankandit publik, si në vijim:

Nr.	Njësia	Sipërfaqja/m ²	Nr. i lokalit/hapësirës	Çmimi fillestar/€
1.	Autolarje	<ul style="list-style-type: none"> • 534.13 Lokal • 1,066.87 Oborr/terase 	25	1,500.00
2.	Hapësire per parking	539.00	33	430.00
3.	Hapësire per parking	435.96	34	500.00
5.	Sportel	3.00	3	200.00
6.	Lokal	8.32	17	174.72
7.	Lokal	8.32	18	174.72
8.	Zyre	382.94	22	800.00

Shënim: Të gjitha çmimet janë pa TVSH.

Kriteri i dhënies së kontratës është çmimi më i lartë i ofruar. Në rast që ekziston vetëm një oferte lidhur me njësinë afariste të caktuar, Bordi i Drejtoreve të ndërmarrjes ka të drejtë të bëjë negociatë me palën e interesuar lidhur me çmimin final të njësisë afariste të caktuar.

Preferencat e dëshirueshme për lëshimin hapësirave me qira gjatë procesit të ankandit:

- Për njësinë "Autolarje" numri i lokalit 25, preferohet ndonjë veprimtari për autolarje, parking të veturave, auto-taksive apo ndonjë kompani autotransportuese për shfrytëzim për nevojat e veta parkimi dhe larje të autobusëve.
- Hapësira për parking në numrin rendor 2, numri i lokalit/hapësirës 33 gjendet përballë hapësirës afariste "Autolarja" dhe mund të përdoret për parking të veturave, autobusëve apo mjeteve tjera.
- Hapësira për parking në numrin rendor 3, numri i lokalit/hapësirës 34, gjendet të hyrja kryesore e ndërmarrjes, përballë rrethit i cili e lidhë stacionin me lagjen Kalabria. Hapësira mund të përdoret për parking të veturave, autotaksive, autobusëve apo mjeteve tjera.
- Për sportelin nr.3 preferohet zyre, apo veprimtari e ngjashme për kompanitë autotransportuese.
- Për lokalet nr.17, nr.18, si dhe për hapësirën afariste "Zyre" preferohet zyre, apo veprimtari të ngjashme, për kompani autotransportuese, apo ndonjë veprimtari tjetër e lejuar dhe e cila nuk bie ndesh me veprimtarinë e NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë ;

Të drejtë pjesëmarrje kanë personat juridik. Si dëshmi ofrojnë certifikatën e regjistrimit të biznesit. Afati i dhënies me qira është një (1) vjeçar me mundësi vazhdimi, bazuar në rregulloren e brendshme lidhur me lëshimin e hapësirave me qira dhe vendosjen e objekteve.

2. Kushtet dhe obligimet tjera

- Nga e drejta e pjesëmarrjes në ankand janë të përjashtuar të gjithë debitorët që kanë obligime të pa shlyera ndaj ndërmarrjes NPL “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. Prishtinë.
- Te gjitha palët e interesuara mund t'i shikojnë hapësirat/lokalet çdo ditë pune nga ora 08:00 deri me 16:00.
- Afati për dorëzimin e ofertave është deri me 16.09.2021, ora 14:00, hapja e ofertave bëhet në orën 14:30.
- Ofertat dorëzohen në zarfe të mbyllura dhe dorëzohen në zyrën e arkivit të ndërmarrjes.
- Të drejtë pjesëmarrje në hapjen e ofertave kanë të gjithë ofertuesit.
- Palët fituese në afatin prej 5 ditësh pas mbylljes së procedurës së ankandit duhet të nënshkruajnë kontratat mbi qiranë, dhe të bëjnë pagesën e faturës së pare.
- Informatat më të hollësishme mund të merren përmes emali-t: : contact@sap-rks.com. apo në numër të telefonit 038 551 333.